

Puna me familjet dhe mbrojtja e fëmijëve nga radikalizimi

Dokument udhëzues me hapa për specialistët dhe politikëbërësit

Hyrje

Kur dikush radikalizohet dhe sillet në mënyrë ekstreme, kjo ndikon jo vetëm tek ai si person, por edhe te familja e tij, shokët, rrethi i gjerë shoqëror dhe shoqëria. Realiteti i sotëm është i tillë ku radikalizimi nuk është një fenomen i pazakontë. Familjet, fëmijët e rritur dhe fëmijët në mbarë BE-në po përballen me rekrutime nga grupe terroriste si ISIS-i, Al Qaida dhe të tjera, me terrorizëm dhe lëvizje ekstremiste të lindura brenda vendit (p.sh. të krahut të djathtë dhe të majtë) dhe me një numër në rritje refugjatësh dhe të kthyerish (duke përfshirë fëmijë, fëmijë të rritur dhe familje) që largohen nga zonat e konflikteve dhe kthehen (sërisht) në BE.

Cilat janë sfidat?

Parandalimi i radikalizimit është në vetvete një sfidë, dhe parandalimi në fazë të hershme është sfidë edhe më e madhe. Megjithatë, kjo duhet të jetë përjasja afatgjatë për të zbutur rrezikun e dhunës që lidhet me ekstremizmin dhe terrorizmin. Për individët vulnerabël dhe mjedisin e tyre social, sfidat aktuale të parandalimit janë:

- *Zbulimi i atyre që janë në rrezik radikalizimi:* në procesin e radikalizimit, ndryshimet mund të ndodhin shumë shpejt, por fazat e hershme të radikalizimit janë të vështira për t'u dalluar sepse indiciet e tyre (sjellja izoluese, irritimet) janë të ngjashme me probleme të tjera, si varësia ndaj substancave.
- *Arritja e krijimit të kontaktit me ta dhe mbështetja e tyre dhe e familjeve të tyre për të ndryshuar drejtimin:* familjet dhe mjedisi social luajnë një rol kyç në këtë proces, siç do të shpjegohet në përjasjen me hapa.
- *Mbështetja e individit dhe e familjes së tij gjatë procesit të shkëputjes:* bashkëpunimi është kyç për të qenë efikas, por nuk arrihet lehtë gjithmonë. Gjithashtu, nuk është gjithmonë pozitive marrëdhënia mes individit dhe mjedisit të tij social, gjë që mund ta ketë nxitur atë pikësëpari drejt ekstremizmit ose terrorizmit.

Përveç këtyre sfidave të përgjithshme, një prej çështjeve kyçe në këtë moment (pranverë 2017) janë familjet dhe fëmijët që janë përballur me dhe/ose përfshirë në terrorizmin e shkaktuar nga ISIS-i, Al Qaida dhe organizata të tjera terroriste, dhe që janë radikalizuar. Gjatë disa viteve të fundit, me mijëra evropianë, mes tyre familje dhe fëmijët e rritur, kanë udhëtuar drejt Sirisë dhe Irakut për të jetuar dhe luftuar për organizatat terroriste. Në këtë moment, numri i luftëtarëve të huaj që udhëtojnë drejt zonave të konflikteve duket në rënie; megjithatë, ka shqetësime se numri i të kthyerve do të rritet. Në të njëjtën kohë, Shtetet anëtare të BE-së kanë njohur një rritje të ekstremizmit të djathtë në mbarë Evropën, të nxitur nga flukset e refugjatëve. Në këtë kontekst të polarizimit në rritje dhe ekstremizmit në rritje, familjet që janë prekur direkt kanë vështirësi me pasojat dhe trishtimet e përditshme.

Për shembull, megjithëse përvoja me të kthyerit është e kufizuar, janë në rritje kërkesat nga familjet që duan që fëmija i tyre të kthehet. Ekzistojnë sfida në trajtimin e këtyre kërkesave:

- në shumë shtete politika se si trajtohen të kthyerit nuk është gjithmonë e qartë për faktorët e ndryshëm, gjë që e bën të vështirë që familjeve t'u jepet informacioni i duhur;
- ISIS-i po përhap propagandë kërcënuese rreth kthimit;
- ka shumë vështirësi praktike në lidhje me dokumentet, sidomos kur bëhet fjalë për fëmijë që kanë lindur në zonat e konflikteve;
- prindërit kanë tendencën t'u dërgojnë para fëmijëve për t'u kthyer, por këto transferta mund të konsiderohen si aktivitete kriminale në disa shtete, prandaj punonjësit e familjeve duhet t'ua shpjegojnë këtë prindërve dhe t'i paralajmërojnë të mos e bëjnë këtë gjë.

Synoni dhe përdorni dokumentin udhëzues me hapa

Synimi i këtij dokumenti është të mbështesë dhe të ofrojë udhëzim për politikëbërësit dhe specialistët përgjegjës për parandalimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm në ambientin e familjes, veçanërisht ato që përfshijnë fëmijë (të vegjël). Ky udhëzues është rezultat i ndarjes së informacioneve, mësimëve, shembujve praktikë dhe rekomandimeve të politikave nga fusha. Seti i mjeteve fokusohet te familjet dhe fëmijët dhe e trajton radikalizimin në një gamë të gjerë skenarësh:

- familjet që kanë një ose më shumë anëtarë familjeje që janë vulnerabël ndaj procesit të radikalizimit (duke përfshirë fëmijët dhe të rinjtë);
- familjet që kanë një ose më shumë anëtarë familjeje që kanë ndërmarrë veprime ekstreme si largimi nga shtëpia për t'u bashkuar me një grup ekstremist (duke përfshirë fëmijët dhe të rinjtë);
- familjet dhe fëmijët që janë larguar nga zonat e prekura nga grupet terroriste;
- familjet që kanë një ose më shumë anëtarë familjeje janë në burg, të dënuar për krime të lidhura me terrorizmin.

Ky dokument i adresohet ekstremizmit bazuar në ideologji të ndryshme (ekstremizëm me frymëzim fetar, ekstremizëm i djathtë, ekstremizëm i majtë, ekstremizëm nacionalist). Në shumë raste,

sfidat dhe përgjigjet e përshkruara në këtë set mjetesh kanë aplikim të gjerë. Nëse jo, kjo do të tregohet specifikisht.


Ai bazohet në rezultatet e takimit të përbashkët mes Grupit të Punës të RAN Youth, Families and Communities (RAN YF&C) dhe Grupit të Punës të RAN Health and Social Care (RAN H&SC), të zhvilluara në Nisë në datat 2 dhe 3 shkurt 2017. Janë përfshirë gjithashtu informacione shtesë që vijnë nga takimet e veçanta të RAN YF&C dhe RAN H&SC mbi rolin e familjeve dhe rolin e fëmijëve, së bashku me përshtypje nga intervistat me gjashtë profesionistë të mbështetjes së familjeve (nga Danimarka, Norvegjia, Holanda, Franca, Belgjika dhe Gjermania).

Termet kryesore:

- Familje: një grup personash që janë të lidhur përmes lidhjes së gjakut (përmes lindjes së pranuar), lidhjes së afërsisë (me martesë ose marrëdhënie të tjera), bashkëjetesës ose kombinim i këtyre;
- Fëmijë: një person nën moshën 18 vjeçare. Në terma ligjorë, ekzistojnë ndryshime mes shteteve në lidhje me moshën kur dikush konsiderohet i mitur;
- Fëmijë i rritur: të miturit e një moshe specifike, zakonisht 14-18 vjeç;
- I kthyer: një individ që është larguar nga shteti i tij për t'u bashkuar me një grup ekstremist në një shtet tjetër dhe që:
 - a. ka kërkuar të kthehet në një shtet të BE-së; ose
 - b. është kthyer në shtetin e tij në BE; ose
 - c. udhëton drejt një shteti tjetër të BE-së.

ITË përfshiheni dhe të punoni me familjet që përballen me radikalizimin

Ky dokument paraqet një përjasje me 10 hapa për të punuar me familjet. Hapat janë përshkruar në grafikun e mëposhtëm si rreth ndërsa influencojnë njëri-tjetrin. Hapat kanë aplikim të gjerë si edhe aplikim sipas rastit. Aty ku është e mundur, hapat janë shpjeguar dhe ilustruar me praktikë në jetën reale. Aty ku aplikohet, ndahen edhe rekomandimet e politikave. Përpara se të shpjegohen hapat, ndahen parimet themelore që krijojnë themelet e një përjasjeje të mirë për mbështetjen e familjeve. Vini re se hapat janë, si përkufizim, një thjeshtim i një realiteti më kompleks në të cilin hapat e ndryshëm merren shpesh njëkohësisht.



Parimet kyçe që formojnë themelet e përqasjes me hapa

Familjet:

- Familjet janë bërthama e rezistencës së një individi. Ka studime të shumta që tregojnë influencën e ambientit të familjes, mënyrën e rritjes së fëmijëve dhe sasinë e dashurisë, kujdesit dhe vëmendjes, në rezistencën e personit ndaj tundimeve negative, si p.sh. bashkimin me grupe terroriste.¹
- Anëtarët e familjes duhet të shihen si partnerë në sinjalizimin, parandalimin dhe mbrojtjen e individëve që janë në rrezik radikalizimi, si dhe në kontribuimin në sigurinë e shoqërisë.

Mbështetja e familjes:

- Objektivi i punës së familjes duhet të jetë përfshirja, ndërtimi i besimit dhe formimi i marrëdhënieve gjatë një periudhe më të gjatë kohe. Kjo jo vetëm mund të influencojë në situatën e drejtpërdrejtë të familjes në mënyrë pozitive, por mund t'i hapë derën personit të rrezikuar si edhe komunitetit më të gjerë.

¹ Walsh F. (2012) "Proceset normale të familjes". Kapitulli 17: Rezistenca e familjes. New York: Guilford Press.



Centre of Excellence

- Është e rëndësishme që të merret një përjasje sistematike ndaj familjes, për t'i parë familjet si të tëra dhe dinamikat mes anëtarëve të familjes. Fokusimi vetëm te individ i rrezikuar ose te një prej anëtarëve të familjes shpesh nuk mjafton për të kuptuar influencat dhe presionet që ekzistojnë dhe formojnë sjelljen e dikujt. Mjedisi shoqëror ose komuniteti i familjes ndikojnë gjithashtu te qëndrimet dhe sjellja. Megjithatë synimi i këshillimit është të mbështesë një individ në rrezik, për ta bërë këtë është e rëndësishme të kuptohet konteksti më i gjerë i familjes dhe i komunitetit.
- Për të ofruar mbështetje efektive për familjen, është e rëndësishme një qëndrim bashkëpunues nga të paktën një pjesë e familjes. Nëse një familje nuk do që të bashkëpunojë ose të marrë mbështetje, do të jetë shumë sfiduese të punohet mbi çështjet shpesh shumë të ndjeshme dhe sfiduese të radikalizimit. Ofrimi me detyrim i mbështetjes për një familje është shumë sfidues dhe ndonjëherë ka efekte të kundërta. Për këtë arsye, ka disa raste kur familja nuk do të jetë faktor lidhës, dhe për të arritur individët e rrezikuar duhet të përdoren lidhje të tjera.
- Përdorni një përjasje sipas pranimit, të paktën për të filluar përfshirjen. Qendra e përjasjes së bazuar te pranimit është që një punonjës familjesh nuk e denoncon ose refuzon perspektivën dhe sjelljen e një familjeje dhe/ose të individit të rrezikuar, por e përdor këtë si pikënisje për përfshirjen. Duke ndërtuar një marrëdhënie të bazuar te mirëbesimi, është e mundur që ngadalë të ndihmohet familja dhe individ i rrezikuar për të ndryshuar qëndrimet dhe bindjet e tyre. Fokusimi prandaj është më shumë te ndërtimi i marrëdhënieve.
- Merrini seriozisht përgjigjet e anëtarëve të familjes, qoftë vetëm për arsye parandaluese. Kjo mund të përfshijë anëtarë të familjes që thonë se vajza e tyre po konvertohet, ose thonë se kanë marrë lajme se fëmija i tyre ka vdekur (edhe nëse nuk ka prova fizike, si p.sh. trup apo certifikatë vdekjeje).

Siguria:

- Vendosja e theksit te siguria, në kombinim me mosbesimin e përgjithshëm mes disa familjeve dhe komuniteteve ndaj autoriteteve, mund të krijojë një spirale negative mosbesimi. Nga perspektiva e mbrojtjes, duhet të ketë një theks te kuptimi i problemeve, por edhe te nevojat që kanë familjet për të kapërcyer këto probleme. Objektivi duhet të jetë që të ndihmohen familjet të zhvillojnë rezistencë afatgjatë ndaj radikalizimit, jo vetëm të zgjidhin situatën aktuale.
- Gjithashtu, vendoset theksi te transparenca ndaj familjes në vend të mbajtjes së sekretëve dhe te puna me familjen në vend që të punohet me çështjen pa përfshirjen e tyre.
- Duhet të theksohet se përfshirja e policisë dhe e shërbimeve të inteligjencës është e nevojshme dhe e rëndësishme. Megjithatë, është po aq i rëndësishëm edhe koordinimi dhe bashkëpunimi mes tyre dhe organizatave ose profesionistëve që fokusohen te parandalimi dhe mirëqenia e familjeve.

Hapi 1. Identifikimi i një rasti (të mundshëm) radikalizimi brenda familjes

Ka shumë mënyra të ndryshme sesi mund të raportohet te autoritetet dhe/ose profesionistët një rast (i mundshëm) radikalizimi. Ka një gamë të gjerë njerëzish që mund të duan të raportojnë shqetësimet. Në shumë raste këta janë familja ose dikush në rrethin e tyre shoqëror (p.sh. shoqëti). Por shqetësimet mund të shprehen edhe nga mësuesit, ata që punojnë me të rinjtë, klubet sportive, organizatat fetare dhe fqinjët. Është e rëndësishme që personat të dinë se ku mund t'i ndajnë shqetësimet e tyre. Përvoja evropiane është se rastet e shqetësimeve raportohen përmes kanaleve të mëposhtme:

- direkt te policia (lokale), qoftë për shkak të shqetësimeve apo të frikës se po ndodh diçka kriminale;
- përmes linjave telefonike të përgjithshme ose speciale: shumë shtete evropiane kanë tashmë linja telefonike 24 orëshe për parandalimin e krimit, por gjithnjë e më shumë (në Holandë, Gjermani, Austri, Francë, Luksemburg) janë gjithashtu në dispozicion linja telefonike të specializuara për personat që kanë shqetësime rreth radikalizimit;
- përmes rrjeteve dhe platformave jozyrtare, si xhamitë, klubet sportive, platformat online;
- përmes profesionistëve të tjerë, siç janë punonjësit socialë dhe ata që punojnë me të rinjtë, mësuesit dhe profesionistët e shëndetit mendor.

Natyra e shqetësimeve të shprehura mund të ndryshojë shumë. Një nënë mund të telefonojë sepse vajza e saj është bërë myslimane dhe do të hajë dhe të vishet sipas traditës islame. Një fqinj mund të dallojë simbole ose flamuj specifikë në shtëpinë e fqinjit. Një mësues është konfrontuar nga nxënës që shprehin ide ekstremiste. Një baba mund të dyshojë se i biri dëshiron të udhëtojë jashtë vendit për t'u bashkuar me një grup ekstremist. Një anëtar i familjes mund të kontaktojë kur merr lajme se vëllai i tyre (për shembull) ka vdekur në një zonë me konflikt terrorist.

Secili shqetësim duhet të merret seriozisht dhe të vlerësohet. Do të jenë shumë raste në të cilat, pasi pyetet dhe kërkohet për informacion shtesë, në vend të radikalizimit identifikohet një sjellje rebele që kërkon vëmendje, ose interes i pastër në një fe të re. Megjithatë, nga këndvështrimi i parandalimit, janë sërish të rëndësishme përgjigjet për ndryshime më pak shqetësuese në sjellje për të parandaluar individët që të shtyhen në një fazë të mëvonshme në një drejtim ekstremist. Marrja e shembullit të nënës dhe vajzës, reagimi i prindërve ndaj një dëshire për t'u konvertuar mund të ndikojë nëse ky proces ndodh në një mënyrë të hapur, transparente dhe të besueshme, ose një në të cilën ajo nxirret jashtë nga mjedisi i familjes.

Praktika në veprim: linja telefonike për radikalizimin, Hayat, Gjermani

Hayat është një program këshillimi gjerman për personat që janë tashmë të përfshirë në grupe radikale selafiste ose në rrugën drejt radikalizimit të dhunshëm xhihadist. Rastet e mundshme të radikalizimit ndonjëherë sillen në vëmendjen e tyre përmes linjës telefonike kombëtare, por më shpesh sepse personat kontaktojnë direkt me Hayat. Hayat ishte një prej partnerëve kyçë në krijimin e linjës telefonike kombëtare në janar 2012. Për arsye referimi (te OJQ-të lokale), linja telefonike kombëtare kërkon që personat të ndajnë të dhënat e tyre personale. Numri i telefonit është anonim. Hayat do ta marrë në çështje vetëm një kërkesë për ndihmë kur vjen direkt tek ata. Ata nuk kontaktojnë me vetë familjet sepse ata e shohin kontaktin nga pala tjetër si thelbësor për dikë që dëshiron të marrë ndihmë.

Më shumë informacion rreth Hayat.

Më shumë informacion mbi mbështetjen e familjeve dhe linjat telefonike mund të gjendet në dokumentet e mëposhtme:

- *Kapitulli i mbështetjes së familjeve të RAN Collection*
- *Dokumenti aktual i RAN: Mbështetja e familjes: çfarë funksionon?*

Rekomandimet e politikës – identifikimi i radikalizimit brenda një familjeje

- Të ofrohet një perspektivë rreth mënyrës se si autoritetet kombëtare i shohin familjet që përballen me këto probleme dhe se si mund të presin që të trajtohen dhe të mbështeten nga qeveria kombëtare, qeveria vendore dhe/ose OJQ-të;
- Të hartohet një infrastrukturë raportimi për ata që kanë frikë dhe shqetësime;
- Të zhvillohet një plan komunikimi, duke përfshirë udhëzime rreth ndarjes së informacioneve, nga një perspektivë kombëtare dhe lokale, rreth mënyrës së komunikimit të kësaj infrastrukture raportimi.

Hapi 2. Diskutimi i një praktike veprimi në një kontekst multi-agjenci

Për t’iu përgjigjur në mënyrë të përshtatshme shqetësimeve të ndara, është e rëndësishme që të jetë e gatshme një infrastrukturë për të trajtuar rastet (e reja) të radikalizimit. Në lidhje me mbështetjen për familjet, vendet evropiane si Belgjika, Suedia, Holanda, Mbretëria e Bashkuar, Danimarka dhe Franca kanë të gjitha kontekstet multi-agjenci në të cilat vlerësohen dhe diskutohen rastet. Shumë prej këtyre konteksteve multi-agjenci janë të organizuara në nivel lokal, sepse shumica e informacionit është e disponueshme në këtë nivel, së bashku me mjetet për t’u përgjigjur.

Për t'iu përgjigjur këtyre konteksteve multi-agjenci përdoren terma të ndryshme: info-house (Danimarkë, shihni shembullin më poshtë), shtëpitë e mbrojtjes (Holandë), tavolinat partnere (Belgjikë), qeliza e monitorimit qeveritar (Francë). Çfarëdo që të quhen, partnerët e mëposhtëm janë zakonisht pjesë e këtyre konteksteve multi-agjenci:

- policia (lokale dhe kombëtare);
- kujdesi social dhe/ose kujdesi i shëndetit (mendor);
- autoritetet vendore;
- kur është e përshtatshme dhe e rëndësishme, partnerët e tjerë siç janë përfaqësuesit e arsimit, agjencitë e punësimit, organet specifike të kujdesit psikologjik mund të përfshihen për çështje të veçanta;
- shërbimet e inteligjencës zakonisht nuk janë partner standard, por bashkëpunimi me to zhvillohet sipas rastit.

Kur çështje të reja hyjnë në një kontekst multi-agjenci, informacioni shkëmbehet në mënyrë që të zhvillohet një kuptim më i mirë i rreziqeve dhe faktorëve mbrojtës që janë në lojë. Diskutimet gjithashtu mbulojnë se sa urgjente duket situata dhe cili prej partnerëve është në pozicionin më të mirë për të bërë kontaktin e parë. Kur ka një situatë krize (p.sh. një anëtar i familjes mund të jetë duke planifikuar një sulm) dhe/ose siguria e profesionistëve të tjerë mund të jetë në rrezik, policia do të bëjë kontaktin e parë. Në rastet e tjera, partnerët do të ofrojnë të diskutojnë se kush është i përfshirë tashmë me familjen. Duke qenë se ndërtimi i besimit mes familjes dhe autoriteteve është shumë i rëndësishëm, kanali më i efektshëm është krijimi i kontaktit përmes dikujt që ka tashmë një marrëdhënie pozitive me familjen. Në disa raste, ky mund të jetë një punonjës social ose i familjeve, por mund të jetë edhe dikush nga zyra e punës.

Për më shumë informacion rreth krijimit të një strukture multi-agjenci (duke përfshirë çështjet që lidhen me ndarjen e informacionit), lexoni kapitullin 2 të [Dokumentit të politikës së RAN - Zhvillimi i një kuadri lokal parandalues dhe i parimeve të udhëzimit](#).

Praktika në veprim: strukturat info-house dhe ndarjet e informacionit, Danimarkë

Në Danimarkë, mbështetja e familjes është e organizuar brenda një info-house. Info-house është një vend takimi ku, mes të tjerash, takohen oficerët e policisë, punonjësit socialë, psikiatrët dhe parandaluesit e krimit për të diskutuar çështjet e reja dhe aktive, dhe për të hartuar plane për secilin rast. Strukturat info-house janë pjesë e modeleve daneze SSP (shkollat, shërbime sociale dhe policia) dhe PSP (policia, shërbimet sociale dhe psikiatri). Të afërmit ose miqtë e shqetësuar mund të kontaktojnë me info-house për të raportuar radikalizimin e dyshuar. Së bashku ata vendosin se cili partner është në pozicionin më të mirë për të kontaktuar me individin në fjalë, dhe të koordinojnë se çfarë do të bëjë secili. Takimet e info-house zhvillohen çdo dy javë. Nga ana institucionale, praktika është e përfshirë brenda mënyrave të punës së autoriteteve kombëtare sociale dhe të zbatimit të ligjit, dhe prandaj është shumë e qëndrueshme.

Paragrafi 115 në ligjin danez jep udhëzime ligjore rreth ndarjes së informacioneve për parandalimin e krimit. Këto udhëzime ligjore ndiqen gjithashtu në kontekstin multi-agjenci të info-house dhe për çështjet që përfshijnë radikalizimin. Një element i rëndësishëm i paragrafit 115 është se gjatë takimeve nuk mbahet procesverbal. Informacioni përpunohet nga profesionistët individë bazuar vetëm në kodin e sjelljes të profesionit të tyre për ndarjen e informacioneve. Prandaj, do të ketë ndryshime mes mënyrës se si përdoret informacioni nga policia dhe punonjësit socialë.

Më shumë informacion rreth sistemeve daneze [SSP](#) dhe [PSP](#).

Rekomandimet e politikës - Diskutimi i veprimeve të mundshme në një kontekst multi-agjenci

- Të mundësohet një infrastrukturë multi-agjenci në të cilën rastet e radikalizimit mund të diskutohen mes sektorëve të ndryshëm dhe të rëndësishëm (policia lokale, punonjësit socialë, edukatorët, psikologët, mjekët e përgjithshëm etj.);
- Të ofrohen udhëzues ligjorë rreth ndarjes së informacionit, protokolleve të privatësisë dhe çfarë duhet bërë në situata me rrezik të lartë ose kërcënimeve ndaj sigurisë;
- Të alokohen burime në nivel kombëtar dhe lokal për profesionistët që punojnë me rastet e radikalizimit.

Hapi 3. Krijimi i kontaktit me familjen

Pasi të jetë vendosur se kush është në pozicionin më të mirë për të kontaktuar me familjen, forma më e zakonshme e kontaktit është vizita në shtëpi. Përjasja që ndërmerret varet shumë nga niveli i parashikuar i rrezikut. Në situatat e krizës ose ato me rrezikshmëri të lartë, policia mund të shpërthejë derën. Shtëpia mund të kontrollohet për individë apo prova. Kjo shpesh është një përvojë shumë publike dhe traumatizuese për familjet, dhe duhet të organizohet ndjekje nga një punonjës social ose i familjeve.

Në raste më pak urgjente, vizita në shtëpi do të bëhet nga një ose dy profesionistë, që do të marrin drejtimin e çështjes dhe do të bëjnë kontaktin e parë me familjen. Në shtete të tilla si Norvegjia, Belgjika dhe Danimarka, kjo dyshe përbëhet nga një oficer policie dhe një punonjës social ose që punon me familjet. Është e këshillueshme për familjet që të mbeten me të njëjtët persona kontakti në mënyrë që të mund të krijohet një marrëdhënie besimi.

Përfshirja me familjen

Përvoja ka nxjerrë mësimet e mëposhtme gjatë përfshirjes me një familje që (ndoshta) është duke u përballur me radikalizimin:

- duke vizituar familjen në shtëpinë e tyre do ta bëjë vizitën më pak kërcënuese dhe ata mund të flasim brenda zonës së tyre komode;
- duke qenë se kjo shpesh është pikënisja për ndërtimin ose ruajtjen e një marrëdhënieje besimi, është e rëndësishme që të ketë transparencë të plotë rreth personave që vizitojnë familjen, pse po e bëjnë vizitën dhe çfarë ndodh nëse familja nuk bashkëpunon;
- mund të jetë e dobishme që të mos fokusoheni menjëherë te çështja e radikalizimit, por t'i kërkohe familjes se me çfarë po përballen dhe se si mund t'u ofrohet mbështetje;
- mund të jetë e dobishme nëse policia (lokale) nuk është me uniformë, por me rroba civile – kjo e bën situatën më pak kërcënuese dhe shmang turpin që mund të sjellë stigmatizimi në lagje;
- aty ku çështja përfshin persona të mitur, duhet të vendoset nëse i mituri do të përfshihet në kontaktin e parë
- nëse po, vizitat është më mirë të zhvillohen jashtë orarit të shkollës.

Familjet që nuk duan të bashkëpunojnë

Specialistët kanë treguar se në shumicën e rasteve, familjet janë të gatshme të bashkëpunojnë sepse edhe ato kanë shqetësime dhe duan më të mirën për anëtarët e familjes të tyre dhe për veten e tyre. Megjithatë, ka raste në të cilat familja refuzon të përfshihet. Këshillat nga specialistët se si të trajtohen këto situata përfshijnë sa më poshtë:

- investoni kohë dhe vazhdoni të përpiqeni përmes çdo rruge të mundshme ose partneri në rrjet për të krijuar kontakt me familjen;
- theksoni faktin se ju doni t'i mbështesni dhe t'i ndihmoni me çështjet e tyre dhe se keni mundësitë që ta bëni këtë;
- tregoni pasojat se nëse ata nuk duan të punojnë me punonjës social ose të familjeve
- duhet të presin që t'u shkojë policia për vizitë;
- nëse është e mundur brenda kuadrit ligjor, përfshirja e mbrojtjes së fëmijës mund të jetë opsioni i fundit në rastin kur fëmijët janë në rrezik - fëmija ose fëmijët mund t'i merren familjes;
- nëse është e mundur brenda kuadrit ligjor, si opsioni i fundit mund të ndërpritet ndihma sociale ose forma të tjera asistence, duke detyruar kështu bashkëpunimin.
- Kur nevojiten procedura ligjore për të zbatuar bashkëpunimin, kjo është provë mungese besimi; në këto raste, puna me familjen ka më pak mundësi që të jetë efikase.

Kush duhet të përfshihet nga familja?

Ka perspektiva të ndryshme se kush duhet të përfshihet në kontaktin me familjen:

- kur synohet për transparencë të plotë, do të përfshihet fëmija, fëmija i rritur ose i rrituri që besohet se po radikalizohet;
- në disa raste, personi rreth cilit janë shprehur shqetësime (p.sh. nga një anëtar i familjes) nuk është informuar dhe/ose përfshirë sepse nëse mëson se familja po kontakton për ndihmë mund të shkaktojë frikë dhe irritim – kjo mund të ndikojë te besimi brenda familjes; në këto raste, mbështetja do t'i jepet direkt familjes, dhe indirekt përmes atyre do të mbështetet personi në fjalë;
- ndonjëherë personi vetë kontakton, për shembull një person i kthyer që ndodhet brenda sistemit gjyqësor (në Gjermani atyre u jepet numri i linjës telefonike); në këto raste, mbështetja i jepet individit – përfshirja e familjes varet nga fakti nëse ka ndikim pozitiv ose negativ;
- nëse një anëtar i familjes ka kontaktuar për ndihmë, por nuk dëshiron që anëtarët e tjerë të familjes ta dinë, është shpesh më e mira që të respektohet ky vendim dhe të punohet me personin që kontaktoi; më vonë mund të merret vendim nëse ka hapësirë për kontakt më të gjerë me familjen.

Praktika në veprim: puna përmes punonjësit kyç - Gjermani

Legato është një organizatë që punon me një gamë të tjerë ideologjish ekstremiste, që variojnë nga ekstremizmi i djathtë deri te radikalizmi fetar. Ajo ka një përqasje të bazuar te pranimi, dhe fokusohet te puna ndërhyrëse, dhe te ofrimi i këshillave për anëtarët e familjeve në veçanti.

Legato nuk është organizatë kontaktuese. Kontakti fillestar duhet të kryhet nga “punonjësi kyç” – ai që është më i afërt me individin në rrezik / personin e radikalizuar (i quajtur “klienti i indeksuar”). Ky “punonjës kyç” mund të jetë, mes të tjerash, një i afërm, mësues ose punonjës social, dhe zakonisht është ai që kontakton me Legato në radhë të parë. Shumica e rasteve ndiqen përmes punonjësit kyç, sepse ata kanë shpesh besimin e personit dhe një marrëdhënie me të.

[Më shumë informacion mbi Legato](#)

Rekomandimet e politikës - krijimi i kontaktit me familjen

- Të ketë një kuadër të qartë ligjor për familjet që nuk bashkëpunojnë. Ky kuadër duhet të komunikohet në një kontekst multi-agjenci, së bashku me udhëzimet se kur mund/duhet të merren masat represive. Kuadri ekzistues ligjor mbi mbështetjen e familjes dhe mbrojtjen e fëmijëve mund të drejtojë zhvillimin e udhëzimeve ligjore shtesë.
- Lejoni hapësirë për një strukturë mbështetëse proaktive (p.sh. bazuar mbi inteligjencën dhe/ose reaguese (bazuar mbi një shqetësim të shprehur nga dikush brenda ose i afërt me familjen), në varësi të kontekstit dhe organizatave që janë në kontakt të drejtpërdrejtë me familjen.

Hapi 4. Bërja e një vlerësimi të rreziqeve dhe nevojave

Me informacionin e grumbulluar gjatë vizitave fillestare bëhet një vlerësim i rreziqeve dhe nevojave të familjes, si në lidhje me çështjen e radikalizimit, ashtu edhe në kontekstin më të gjerë. Praktika aktuale tregon se në shumicën e shteteve të BE-së, policia është përgjegjëse për një vlerësim të rrezikut nga perspektiva e sigurisë. Punonjësit e familjes do të jenë më të përfshirë në përcaktimin e shqetësimeve dhe nevojave të familjes. Shumica e punonjësve të familjes nuk kanë një mjet zyrtar për vlerësimin e nevojave, por punojnë me një formular informacioni. Ky formular ndryshon sipas shtetit, por është pjesë e rëndësishme e dosjes së secilit rast mbi individin dhe familjen sepse përfshin informacione mbi:

- historikun personal të individit në fjalë dhe rrethit të tij familjar/shoqëror;
- lidhjet mes individit, familjes dhe kontakteve të tjera sociale, për shembull klubet sportive, shkolla, rrethet fetare dhe vendet e tjera (përmbledhja e rrjetit);
- çështjet praktike me të cilat po përballon familja dhe/ose individit si p.sh. papunësia, problemet e strehimit dhe sfidat e arsimimit dhe në të cilat ata kanë nevojë dhe duan ndihmë dhe mbështetje;
- ngjarjet aktivizuese në historikun e individit ose të familjes;
- natyrën dhe nivelin e shqetësimeve (informacioni i sfondit).

Nuk ka asnjë formular ose këshillë standarde që tregon se si duhet të duken, sepse dosja e çështjes zakonisht përmban shumë informacione delikate dhe pyetje specifike që janë me rëndësi për profesionistët e mbështetjes së familjes.

Dosja e çështjes është një burim kyç informacioni dhe udhëzues për organizatat e ndryshme që punojnë me familjen. Prandaj, është e rëndësishme që të ketë një përgjegjës të qartë për çështjen dhe të ketë mekanizma ndarjeje të cilët lejojnë që dosja e çështjes të jetë sa më gjithëpërfshirëse që të jetë e mundur. Mund të jetë e dobishme që në këto dosje të përfshihen kanale dixhitale komunikimi siç janë emaillet dhe protokollet e bisedave në median sociale.

Rekomandimet e politikës – vlerësimet e rrezikut dhe nevojave

- Të disponohet një sistem për ndarjen e informacioneve që lejon që të gjitha palët përkatëse të monitorojnë dosjet e çështjeve dhe të ndajnë informacione të rëndësishme dhe delikate;
- Të jepen udhëzime mbi aplikacionet e teknologjive të informacionit dhe komunikimeve (ICT) dhe sigurimin e burimeve të informacionit në internet që mbështesin sistemin e ndarjes së informacioneve.

Hapi 5: Nevojat specifike të fëmijëve dhe të fëmijëve të rritur

Kur fëmijët rriten në një mjedis të radikalizuar, ata janë të rrezikuar ndaj kalimit të radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm nga njëri brez në tjetrin. Kështu ndodh me fëmijët e radikalizuar në Evropë (si ekstremistët e djathtë ashtu edhe ata me frymëzim fetar), fëmijët e radikalizuar në zonat e luftës, dhe ata që janë në kontakt me anëtarë të radikalizuar të familjes. Është e rëndësishme që specialistët të fuqizohen që jo vetëm të interpretojnë shenjat e radikalizimit, por edhe të përfshihen me efektshmëri me fëmijët që janë në një mjedis të radikalizuar.

Sfida aktuale: fëmijët e lindur/rritur në zonat me konflikte terroriste

Një shqetësim i madh sot janë fëmijët e lindur jashtë vendit dhe/ose që jetojnë jashtë vendit në zonat me konflikte terroriste, p.sh. në Siri dhe Irak. Këta fëmijë që jetojnë në të ashtuquajturin kalifat të kontrolluar nga ISIS-i janë shqetësim i veçantë për shkak të arsyesimit të fortë ideologjik ndaj të cilit janë të ekspozuar, si edhe mënyrës se si përdoren dhe përgatiten fëmijët për t'u bërë ushtarë. Fëmijët që jetojnë në këto ambiente mund të ekspozohen ndaj:

- indoktrinimit të thellë përmes ideologjisë ekstremiste;
- traumave të rënda të shkaktuara nga jetesa në një mjedis konflikti dhe dhune ekstreme;
- stërvitjes luftarake (më shumë djemtë se vajzat);
- vrasjeve dhe sulmeve vetëvrasëse – edhe si dëshmitarë, edhe si ekzekutues;
- abuzimit dhe manipulimit fizik, mendor, seksual dhe emocional – sërish, edhe si dëshmitarë, edhe si viktimë.

Deri më tani, nuk janë të shumtë ata specialistë që kanë pasur përvojë pune me fëmijët e vegjël që janë kthyer nga Siria ose Iraku. Megjithatë, ekziston përvoja e punës me fëmijët që janë rritur në zonat e luftës dhe ushtarë fëmijë. Mësimet dhe informacionet nga kjo fushë mund të jenë të dobishme për të zhvilluar praktikë të mirë në këtë fushë.

Mësimet dhe përjasjet për punën me fëmijët

Sa herë që fëmijët ose fëmijët e rritur radikalizohen ose janë influencuar nga një person i radikalizuar në mjedisin e vet të drejtpërdrejtë, ekzistojnë disa hapa që mund të merren:

- Mund të jetë e efektshme puna me metodat e përgjithshme të parandalimit të hershëm, siç janë ushtrimet rreth identitetit, përkatësisë, menaxhimit të konflikteve, mendimit kritik, demokracisë, marrëdhënieve familjare etj. Ndërhyrja e hershme është jetësore për fëmijët nën moshën 12 vjeçare, për të maksimizuar mundësinë e rehabilitimit të suksesshëm. Këto ushtrime duhet të aplikohen nga individë të kualifikuar dhe me kompetencë kulturore, të mbështetur nga komuniteti dhe rjetet e njohura me ligj të profesionistëve.
- Krijimi i një vendi të sigurt dhe atmosferë konfidence dhe besimi është themelor që fëmijët të flasin lirshëm.

- Kur fëmijët e rritur bëjnë tranzicionin nga shërbimet e fëmijëve në ato të të rriturve, zakonisht kur mbushin 18 vjeç, është e rëndësishme që profesionistët e specializuar për fëmijët dhe të rriturit të bashkëpunojnë për të maksimizuar vazhdimësinë në ndihmën që u jepet këtyre fëmijëve.
- Përfaqset krijuese që bazohen te muzika, teatri, sporti etj. mund të punojnë mirë me fëmijët. Një shembull është “biblioteka e gjallë (ose njeriu bibliotekë”); një mjet barazie që përpiqet të sfidojë paragjykimet duke mundësuar një bisedë mes dy personash.
- Sa për fëmijët që janë kthyer nga zonat e luftës, siç është Siria, duhet marrë në konsideratë sa vijon:
 - studimet mbi ushtarët fëmijë tregojnë se është e këshillueshme që të niset me kryerjen e aktiviteteve normale të përditshme.
 - ideologjia është identiteti i tyre; ajo i mbron ata dhe i ndihmon të kuptojnë botën. Vetëm përvojat e reja që janë jashtë kësaj ideologjie do të bëjnë të mundur që ata të mendojnë ndryshe.
- Aty ku fëmijët e kthyer janë përfshirë në dhunë, një zgjidhje e drejtësisë penale ka potencialin të traumatizojë më tej fëmijën, të sjellë recidivizëm në të ardhmen dhe të kufizojë mundësitë për rehabilitim dhe riintegrim. Nëse i jepet prioritet një rehabilitimi, atëherë nevojat dhe vulnerabilitetet e fëmijës kanë përparësi, pavarësisht nga natyra e krimit që ai ka kryer.
- Plotësimi i nevojave të fëmijëve të kthyer duhet të informohet nga praktika më e mirë ekzistuese e mbrojtjes së fëmijëve dhe të kryhet brenda rrjeteve kombëtare të themeluara për shërbimet e fëmijëve. As OJQ-të dhe as organizatat bamirëse nuk kanë kapacitetin ose lidhjet me të gjitha shërbimet e nevojshme për të ndërhyrë vetëm dhe prandaj duhen mbështetur nga shërbimet ekzistuese të njohura me ligj.
- Aty ku këto shërbime kanë ndërhyrë dhe është zhvilluar një plan përkujdesjeje për një fëmijë të caktuar, ekspertët e fushës (si liderët fetarë, liderët e komunitetit, dhe ata me përvojë në traumat e konflikteve) duhet të japin kontributin për korrigjimet e këtij plani, duke pasur parasysh njohuritë e tyre unike të çështjeve kyçe.

[Më shumë informacion mbi fëmijët e kthyer nga zonat e konflikteve.](#)

Praktika në veprim: chamäLION, Gjermani

Parandalimi i hershëm është me rëndësi të jashtëzakonshme për fëmijët (e vegjël) që përballen me radikalizmin. chamäLION është një koncept parësor parandalimi që synon të promovojë rezistencën kundër ideologjive ekstremiste. Ideja pas kësaj është parandalimi i radikalizimit duke dhënë mbështetje të hershme në formën e burimeve personale dhe shoqërore, krijimi i pranimit për të tjerët dhe në të njëjtën kohë reduktimi i diskriminimit.

Në zemër të praktikës janë tri module:

- A. Përkatësia dhe orientimi (ndërgjegjësimi për diversitetin/mënyrat e ndryshme të jetesës, bindjet e ndryshme, gjinitë dhe origjinat);
- B. Identiteti dhe pranimi (njohuria e pikave të forta dhe të dobëta, puna biografike);
- C. Menaxhimi i konflikteve (parandalimi i dhunës, mësimi si të trajtohen situatat e konflikteve, ndërgjegjësimi rreth ndjenjave të veta dhe aftësive në komunikim).

chamäLION synon fëmijët në grupmoshën 7-12 vjeç. Mjetet (ushtrimet) janë projektuar për t'u implementuar nga mësuesit ose punonjësit socialë në shkollë.

[Më shumë informacion rreth chamäLION.](#)

Rekomandimet e politikës – plotësimi i nevojave specifike të fëmijëve:

- Të ofrohet një përjasje e balancuar ndaj ndjekjes penale dhe rehabilitimit të fëmijëve dhe fëmijëve të rritur;
- Të përfshihen shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve, specialistët e traumave dhe specialistët nga fushat e përafërta si p.sh. ushtarët fëmijë, për të hartuar një përjasje multi-agjenci;
- Të mundësohet një tranzicion i lehtë nga shërbimet e fëmijëve në ato të të rriturve.

Korak 6. Razprave o tveganjih, potrebah in odzivih v večagencijskem okolju

Pasi janë bërë vlerësimet e rrezikut dhe nevojave nga profesionistë të ndryshëm, ky informacion duhet të ndahet. Siç është diskutuar në hapin 2, informacionet e ndara janë sfiduese për shkak të rregulloreve të privatësisë dhe konfidencialitetit profesionist, si edhe për arsye sigurie. Në disa shtete, si p.sh. në Mbretërinë e Bashkuar, Danimarkë (shihni shembullin në hapin 2) dhe Holandë, ka protokolle specifike privatësie dhe marrëveshje për ndarjen e informacionit, që japin udhëzime në këtë proces.

Në shtete të tilla si Belgjika, Holanda, Danimarka, Norvegjia dhe Gjermania, “përgjegjësi i çështjes” do të jetë profesionisti i mbështetjes së familjes. Megjithatë, edhe profesionistë dhe organizata të tjera do të kontaktohen dhe do të përfshihen në implementimin e planit të ndërhyrjes. Përgjegjësia e çështjes në këto raste nënkupton se profesionisti i mbështetjes së familjes është i ndërgjegjshëm dhe koordinon ndihmën që merr një familje dhe/ose individ.

Praktika në veprim: përfaqësja “Channel”, Mbretëria e Bashkuar

“Channel” është një program që fokusohet te dhënia e mbështetjes në një fazë të hershme për personat që janë identifikuar si vulnerabël për t’u tërhequr në ekstremizëm. Programi përdor një përfaqëse multi-agjenci për të mbrojtur personat vulnerabël:

- duke identifikuar individët e rrezikuar;
- duke vlerësuar natyrën dhe nivelin e atij rreziku;
- duke zhvilluar planin më të përshtatshëm të mbështetjes për individët në fjalë.

Suksesi i programit varet shumë nga bashkëpunimi dhe aktiviteti i koordinuar mes partnerëve. Kjo funksionon më mirë kur individët dhe familjet e tyre përfshihen plotësisht me programin dhe mbështeten në mënyrë të vazhdueshme. Policia e koordinon aktivitetin duke kërkuar informacione përkatëse nga partnerët e panelit rreth një individi të referuar. Ajo do ta përdorë këtë informacion për të bërë një vlerësim fillestar të natyrës dhe nivelit të vulnerabilitetit. Informacioni më pas do t’i paraqitet një paneli.

Ligji i Antiterrorizmit dhe i Sigurisë i vitit 2015 ka për qëllim të sigurojë bashkëpunim efikas lokal dhe aplikimin e Channel në të gjitha zonat dhe të ndërtojë mbi një praktikë të mirë tashmë të aplikuar në shumë fusha.

[Më shumë informacion mbi Channel](#)

Rekomandimet e politikës – diskutimi i rreziqeve, nevojave dhe përgjigjeve:

- Të krijohet një protokoll i qartë për ndarjen e informacioneve;
- Të ofrohen udhëzime rreth personave që duhen dhe nuk duhen përfshirë në kontekstet multi-agjenci;
- Mbështetja e krijimit të një gjuhe “të përbashkët” mes partnerëve bashkëpunues (p.sh. rreth mënyrës se si të tregoni rreziqet).

Hapi 7. Plani i ndërhyrjes. mjetet për të mbështetur familjen

Planet e ndërhyrjes ndryshojnë nga familja në familje. Është e rëndësishme që këto plane të jenë të përshtatura sipas rreziqeve dhe nevojave të familjeve dhe individëve. Profesionistët e mbështetjes së familjeve theksojnë rëndësinë e pasjes së një game ndërhyrjesh në dispozicionin e tyre që të jenë në gjendje të ofrojnë kujdesin dhe mbështetjen më të mirë, si dhe të parandalojnë që radikalizimi të prekë anëtarë të tjerë të familjes.² Për të strukturuar llojet e ndryshme të ndërhyrjes,

² Vini re se pjesëtarët e komunitetit mund t’i perceptojnë familjet që përballen me radikalizmin se marrin trajtim trajtimit ose aksesit “të veçantë».

në këtë dokument do të përdoret përqasja e studiuesit Angel Rabasa³, e përdorur nga Hayat e Gjermanisë. Përqasja është e ngjashme me ndërhyrjet e përdorura në vende të tjera të BE-së.

Ndërhyrjet pragmatike

Në shumë raste, çështjet pragmatike të tilla si papunësia dhe problemet e strehimit mund të pengojnë ofrimin e ndihmës që një familje të stabilizohet dhe të jetë sërish rezistente dhe e aftë të trajtojë një anëtar të radikalizuar/që po radikalizohet në familje. Bazuar në vlerësimin e nevojave, mund të aplikohen ndërhyrjet pragmatike për t'iu adresuar çështjeve të tjera. Zakonisht është gjithashtu edhe një prej mënyrave më të lehta për të ndihmuar një familje dhe mund të ndihmojë në ndërtimin e një marrëdhënieje besimi. Shembuj të ndërhyrjeve pragmatike përfshijnë ndërmjetësimin ndërsa familja lidhet me shërbimet e mirëqenies së të rinjve, shkollat specifike, shoqatat e strehimit, qendrat e punës, klubet sportive ose organizata të tjera sociale.

Praktika në veprim: EXIT Sweden

EXIT Sweden është një program brenda organizatës jofitimprurëse Fryshuset. Qëllimi i tyre është të ndihmojnë dhe të ofrojnë mbështetje për ata që dëshirojnë të dalin nga grupet dhe lëvizjet mbështetjes praktike dhe individuale. EXIT ofron takime personale, një person kontakti (nëse nevojitet i disponueshëm 24 orë në ditë) dhe asiston në kontaktet me agjencitë qeveritare. Ai bashkëpunon me agjencitë e strehimit, policinë, shërbimet sociale, ente të tjera juridike dhe familjen dhe miqtë e personave që duan të dalin. EXIT ofron gjithashtu këshillim për prindërit, vëllezërit/motrat, dhe personat e tjerë pranë klientëve.

Puna është e personalizuar, duke marrë në konsideratë situatën specifike të klientit individual, por zakonisht fokusohet te ndërtimi i një identiteti të ri social jashtë identitetit të mëparshëm ekstremist. Aktivitetet mund të variojnë nga aktivitetet sociale dhe trajnimi social, deri te përfshirja praktike me transferimin, heqjen e tatuazheve, kontaktin me autoritetet e ndryshme etj. Gjatësia e ndërhyrjes ndryshon në varësi të situatës, dhe zakonisht zgjat nga disa muaj në disa vjet.

[Më shumë informacion mbi EXIT Sweden](#)

Rekomandimet e politikës – mjetet për të mbështetur familjet

- T'u jepet profesionistëve lokalë të mbështetjes së familjeve akses i lehtë në shërbimet praktike siç janë strehimi, asistenca për punë, këshillat financiare. Në rastet me rrezikshmëri të lartë, konsideroni të përdorni rrugë të shkurtra te këto shërbime;
- Të caktohen burime shtesë në nivel kombëtar dhe lokal për mbështetjen praktike të këtyre familjeve.

³ Dr Angel M. Rabasa është Shkencëtar i Lartë Politik pranë RAND Corporation që ka shkruar gjerësisht rreth ekstremizmit, terrorizmit dhe kryengritjeve. Ai është autori kryesor i "Deradikalizimi i ekstremistëve islamikë" (2010).

Ndërhyrjet në nivel emocional dhe psikologjik

Një strategji kyçe për grupet ekstremiste (çfarëdo qoftë sfondi i tyre ideologjik) është të ndërpritet lidhja emocionale mes një individit dhe mjedisit të tij shoqëror dhe familjar, si dhe të izolohet individit, duke rritur varësinë ndaj grupit ekstremist. Prandaj, rregullimi i lidhjeve pozitive emocionale me familjen dhe ata që janë në rrethin shoqëror që mbështet shkëputjen, është thelbësor në çdo plan ndërhyrjeje. Kjo lidhet jo vetëm me individin, por edhe me familjen e tij ose të saj. Izolimi nga mjedisi shoqëror është një prej faktorëve më të mëdhenj të rrezikut gjatë përpjekjeve për të parandaluar radikalizimin. Shembuj të ndërhyrjeve që trajtojnë ose kërkojnë ta kthejnë mbrapsht këtë janë:

- **Trajnimi dhe mjetet e komunikimit prind-fëmijë:** prindërit shumë shpesh përpiqen të komunikojnë me fëmijët e tyre kur ata shfaqin shenja të radikalizimit ose madje veprojnë (si p.sh. udhëtojnë drejt Sirisë). Prindërit dhe vëllezërit/motrat mund të përballen me shumë emocione (zemërim, keqkuptim, ndjenja braktisjeje), dhe këto emocione mund të krijojnë kontaktin me fëmijën/vëllanë

/motrën e tyre. Profesionistët e mbështetjes së familjeve dhe organizatat eksperte mund t'u ofrojnë atyre udhëzime rreth mënyrës së mbajtjes së kontaktit pozitiv, mund të shmangin largimin e anëtarëve të familjes më larg, dhe të rregullojnë lidhjet me familjen. Shumë profesionistë të mbështetjes së familjeve raportojnë përdorimin e një forme intervistimi motivues për të trajnuar prindërit në aftësi komunikuese.

- **Grupet e personave të afërt:** prindërit, gjyshërit dhe vëllezërit/motrat mund të përfitojnë nga qenia në kontakt me të tjerët që po kalojnë të njëjtat procese dhe sfida me një anëtar të familjes së tyre. Prezantimi me një grup mbështetjeje me persona të afërt mund të bëhet përmes punonjësve mbështetës për familjet. Pjesëmarrja:
 - mund të ndihmojë shmangien e izolimit social të shkaktuar nga natyra e stigmatizimit si të lidhur me ekstremizmin/terrorizmin;
 - mund t'u japë familjeve një qëllim ose një kanal përmes të cilit mund të ndajnë trishtimin, por edhe përvojën dhe gabimet që të tjerët të mësojnë;
 - mund të ofrojë një burim informacioni shtesë rreth procesit të radikalizimit që mund ta ndihmojë një familje të ndihet më shumë në kontroll të situatës.
 - mund të ndihmojë në stabilizimin e stresit dhe mund të zhvillojë mekanizma më të mirë për t'u përballur me trishtimin, traumën dhe probleme të tjera mendore që mund të jenë të pranishme brenda këtyre familjeve.

- **Ndërhyrjet krijuese:** Është e rëndësishme që të krijohet një mbërritje e butë për personat që janë kthyer ose kanë qenë pjesë e një programi daljeje; kjo ndihmon në parandalimin e recidivizmit. Profesionistët e mbështetjes së familjeve sfidohen të mendojnë jashtë kornizave të zakonshme kur bëhet fjalë për të rregulluar lidhjet dhe shmangur izolimin.

Përdorimi i influencuesve pozitivë (p.sh. imamët, mësuesit, kujdestarët): kur përpiqeni të nxirrni një individ nga izolimi, rindërtimi i marrëdhënieve brenda komunitetit kërkon përfshirjen nga anëtarë komuniteti të besuar dhe të angazhuar, siç janë drejtuesit fetarë, mësuesit ose

këshilluesit e qendrës së komunitetit. Ata mund të shërbejnë si urë mes familjeve vulnerabël dhe komuniteteve fuqizuese. Gjithashtu, në çështjet fetare ata mund t'i drejtohen individit nga brenda të njëjtës pikëpamje dhe pa u parë sikur kërkojnë ta ndryshojnë këtë.

- Në **nivel psikologjik**, është e rëndësishme që të përcaktohet nëse përveç sfidave emocionale, mund të ketë gjithashtu edhe sfida psikologjike ose madje edhe sëmundje mendore dhe trauma. Specialistët e mbështetjes së familjeve theksojnë rëndësinë e bashkëpunimit me kujdesin e specializuar psikologjik dhe psikiatrik për të mbështetur familjet që përballen me këto çështje. Për më shumë informacion rreth trajtimit të traumave mes fëmijëve që kthehen nga zonat e konflikteve, shikoni [Raportin e RAN rreth fëmijëve të kthyer](#).

Praktika në veprim: Grupi i mbështetjes së prindërve – Holandë

Steunpunt Sabr (arabisht do të thotë “durim”) është një organizatë për gra dhe një OJQ e pavarur dhe autonome që punon nga poshtë-lart dhe ofron mbështetje dhe fuqizim për gratë vulnerabël. Me fëmijët e rritur që largohen nga rajoni për në Siri, Sabr ka organizuar një grup mbështetjeje për prindërit. Grupi ka bashkuar prindër nga sponde të ndryshme kulturore, si prindër myslimanë, ashtu edhe prindër të personave të konvertuar. Grupi u rrit shpejt, dhe prindërit janë bashkuar me dëshirë dhe zakonisht e kanë gjetur grupin përmes rrjeteve të tyre. Sabr ka gjithashtu lidhje të ngushta me oficerët e policisë së komunitetit që kanë rekomanduar prindërit, edhe nga zona të tjera, të mbështesin grupin.

Sabr mundëson takime dhe është i pranishëm për të mbështetur prindërit ku është e nevojshme. Nevojat e prindërve janë pikënisja e bisedave. Kur u ngritën shumë pyetje rreth Sirisë, Sabr bëri të mundur që zyrtarë qeveritarë dhe të komunës të bashkoheshin me grupin dhe të jepnin përgjigje. Prindërit pjesëmarrës janë shumë të kënaqur me grupin mbështetës sepse ai ofron një vend ku mund të ndahen përvojat dhe të mësohet nga të tjerët rreth mënyrës së trajtimit të situatës. Faktorët kyçë janë nivele të ulëta të hyrjes (linja komunikimi lokale dhe të shkurtra), fakti se takimet janë të mbyllura dhe në një hapësirë të sigurt (besimi mes pjesëmarrësve dhe organizatës) dhe se Sabr është e pavarur.

[Më shumë informacion rreth Sabr.](#)

Rekomandimet e politikës – trajtimi i emocioneve dhe psikologjisë

- T’u ofrohet profesionistëve të mbështetjes së familjeve një mandat fleksibël për të zhvilluar ndërhyrje jashtë kornizave për të ndihmuar në rregullimin e lidhjeve familjare;
- T’u ofrohen burime organizatave që kanë krijuar/duan të krijojnë grupe personash të afërt për ata që përballen me radikalizimin dhe ekstremizmin.

Ndërhyrjet e fokusuara te ideologjia

Ka shumë arsye bazë për radikalizimin, shumica e të cilave nuk kanë lidhje me ideologjinë. Megjithatë, individët që janë të radikalizuar shpesh tregojnë devocion të fortë ideologjik, qoftë kur janë të nxitur apo jo nga ideologjia. Për ata që kanë një bindje të fortë në ideologji (qoftë kur është me frymëzim fetar apo e ekstremit të djathtë), mund të jetë e vështirë që familja dhe ambienti social të krijojë lidhje me ta. Për të inkurajuar procesin e shkëputjes, është e rëndësishme që individit të jetë në gjendje të ndryshojë perspektivën e tij ose të saj dhe të zhvillojë përgjigje joekstremiste dhe jo të dhunshme për jetën, që më parë drejtoheshin nga ideologjia e dhunshme ekstremiste. Familjet kanë nevojë për mbështetje me këto pika:

- **Mosadresimi i menjëhershëm i ideologjisë:** sado tunduese mund të jetë të konfrontohet personi rreth faktit sa e vërtetë apo sa e drejtë është ideologjia, këto biseda shpesh do të kenë efektin e kundërt. Ato mund të shihen madje si justifikim për t'i trajtuar anëtarët e familjes ose kontaktet shoqërore si "të pabesë", inferiorë, ose të dobët sepse ata nuk kanë të njëjtin botëkuptim me të.
- **Aplikimi i një përjasjeje bazuar në pranimin:** qendra e përjasjes së bazuar te pranimi është që një profesionist i mbështetjes së familjeve ose anëtar i familjes nuk e denoncon ose refuzon perspektivën dhe sjelljen e një familjeje dhe/ose të individit të rrezikuar, por e përdor këtë si pikënisje për përfshirjen. Duke ndërtuar një marrëdhënie të bazuar te mirëbesimi, është e mundur që ngadalë të ndihmohet individit në rrezik për të ndryshuar qëndrimin dhe bindjet e tij. Fokusi prandaj është më shumë te ndërtimi i marrëdhënieve.
- **Përfshirja e diskutimeve ideologjike me ekspertë:** qoftë kur ky është një imam ose një ish-ekstremist i djathtë, mund të jetë e dobishme që të përfshihet dikush që mund të bisedojë me familjen dhe individin rreth dimensionit ideologjik. Nga vjen kjo? Cilat janë burimet dhe pse janë ato të besueshme ose jo? Cilat janë perspektivat alternative?
- **Përfshirja e familjes dhe e kontakteve shoqërore në një program daljeje:** në gjithnjë e më shumë Shtete anëtare të BE-së, po prezantohen programet e daljes (Exit). Shumica kanë një komponent ideologjik. Familja dhe pjesë të tjera të rrethit shoqëror të një individit mund të përfshihen në këto programe. Shikoni burimet më poshtë për më shumë informacion rreth programeve Exit:
 - [Dokumenti aktual i RAN EXIT: Kërkesat minimale metodologjike për ndërhyrjet e daljes](#)
 - [Dokumenti aktual i RAN EXIT: Puna e daljes në një kontekst multi-agjenci](#)
 - [Dokumenti aktual i RAN EXIT: Hartimi i një ndërhyrjeje për daljen](#)

Praktika në veprim: Entr’Autres, Francë

Entr’Autres është një organizatë që kërkon të parandalojë shpërbërjen e lidhjeve shoqërore dhe lidhjeve familjare. Çështjet mbërrijnë përmes rrjetit, linjës telefonike dhe autoriteteve zyrtare. Puna me familjen është kyçe për organizatën: pa ndihmën e familjes, ata nuk mund të punojnë me individin. Nëna është jashtëzakonisht e rëndësishme, sepse përmes saj mund të krijohet një lidhje me individin. Përqasja e Entr’Autres’ për deradikalizimin e një individi varet nga profili i tij ose i saj, për të cilin kanë tri kategori:

- Individët që mund të duken se po radikalizohen, por në fakt thjesht duan të provokojnë. Ata përbëjnë 15-20 % të rasteve dhe janë kategoria më e thjeshtë me të cilët mund të punohet;
- Individët, identiteti i të cilëve është ndërprerë. Ata përbëjnë 60% të rasteve dhe megjithëse puna me këta individë është më e vështirë dhe kërkon investim më afatgjatë, ka sukses dhe ky mund të matet me një ndryshim në rrugën e tyre;
- Individët vërtet të radikalizuar. Ky profil përbën 15-20 % të rasteve dhe deradikalizimi i vërtetë i këtyre personave është pothuajse i pamundur.

Për të gjitha kategoritë, puna me familjet është e rëndësishme, por jo në të njëjtën mënyrë.

Rekomandimet e politikës - adresimi i ideologjisë

- Të ndihmohet në ngritjen e një rrjeti të besueshëm dhe legjitim me ekspertë të teologjisë dhe ideologjisë (studiues islamikë, studiues të krishterë, ish-ekstremistë etj.);
- Të mbështeten programet Exit sipas një vlerësimi të personalizuar të rrezikut dhe nevojave. Ideologjia ndonjëherë shërben për të mbuluar motive të tjera më të thella që duhen adresuar.

Hapi 8. Monitorimi i progresit dhe përshtatja me situatën

Pasi të jetë siguruar mbështetja e familjes bazuar në një plan ndërhyrjeje të personalizuar, është e rëndësishme që të ndiqet se si ndikon kjo në jetën e përditshme. Profesionistët e mbështetjes së familjeve tregojnë se mund të jetë detyrë sfiduese të monitorohen ngjarjet dhe çfarë ndodh brenda familjes, veçanërisht kur familja vetë nuk është proaktive për ta dhënë këtë informacion. Prandaj është e rëndësishme ruajtja e kontaktit të rregullt. Ndërtimi dhe mirëmbajtja e një marrëdhënieje besimi dhe angazhimi është gjithashtu me rëndësi kyçe për të garantuar zbulimin e efekteve/tendencave negative. Duke qenë se vazhdimësia është shumë e rëndësishme, duhet të garantohet gjithashtu mbështetja e qëndrueshme për familjet (shikoni hapin 10 rreth ndërtimit të kapaciteteve).

Në disa raste, familja mund të dojë të tërhiqet nga plani i ndërhyrjes përpara se të jenë arritur objektivat e rëna dakord më herët. Duke qenë se sukcesi kushtëzohet nga bashkëpunimi vullnetar i familjes, shpesh këshillohet që të ndiqen dëshirat e familjes, duke u shprehur qartë se ata mund të bashkëpunojnë sërish në çdo moment. Në rastet me rrezikshmëri të lartë, mund të supozohet se do të vazhdojnë kontrollet e sigurisë dhe të mbikëqyrjes.

Gjatë aplikimit të programit të mbështetjes, profesionistët e mbështetjes së familjeve mund të hasin në kufizime të tjera:

- Rregullat dhe kufizimet e qarta duhet të bihen dakord që nga fillimi. Në grupet e mbështetjes, për shembull, anëtarët e familjeve duhet të flasin për të afërmin e tyre, por ky nuk duhet të jetë një forum për të fajësuar.
- Disa familje mund të mos duan të flasin se çfarë bëjnë të afërmit e tyre, sepse nuk duan të mendojnë rreth turp-it apo stigmës që shoqërohet me veprimet e tyre. Në këto raste, mund të jetë e dobishme që të përfshihet një psikolog, i cili mund të largojë tabutë dhe mund t'i inkurajojë të flasin rreth këtyre çështjeve.
- Është thelbësore që takimet të jenë sa më private dhe konfidenciale që të jetë e mundur. Për shembull, shmangni marrjen e shënimeve gjatë sesioneve me anëtarët e familjes. Specialistët kanë konstatuar se marrja e shënimeve ul besimin dhe krijon një klimë të përhumbës.
- “Hedhja e fajit te institucionet” është e zakonshme. Prindërit mund të fajësojnë shërbimet e sigurisë që nuk parandaluan që fëmija e tyre të shoqërohej me ekstremistë të njohur. Mund të jetë e dobishme të përfshihen palët e “fajësuar” duke ftuar personat (e gatshëm) nga departamentet e qeverisë (shërbimet e sigurisë ose zyra e politikës me jashtë) në takimet dypalëshe ose grupet e mbështetjes.
- Shtimi i një përkthyesi në bisedime mund të kapërcejë disa barrierë gjuhësore, por mund të mos krijojë domosdoshmërisht atmosferën e duhur. Përvoja ka treguar se prindërit/anëtarët e familjeve mund të përkthejnë për njëri-tjetrin dhe se janë më të përfshirë dhe më besues nëse nuk ka përkthyes të jashtëm.

Hapi 9. Ulja e përfshirjes

Përfshirja zakonisht përfundon kur janë arritur objektivat dhe njëra palë (ofruesi i shërbimit ose anëtarët e familjes) ka besim se familja mund të vazhdojë vetë:

- Duhet të përdoret vlerësimi ose monitorimi multi-agjenci për të vlerësuar nëse janë arritur objektivat e mbështetjes së familjes dhe mbështetja mund të përfundojë.
- Shembujt kanë treguar se caktimi i një afati specifik kohor mund të jetë i dëmshëm për angazhimin; aty ku është e mundur ai duhet të përfundojë natyrshëm dhe jo të diktohet nga kapaciteti dhe burimet.
- Duhet të kihet parasysh se në të vërtetë përfshirja mund të mos “përfundojë” asnjëherë. Duhet të ketë gjithmonë një derë të hapur ose një individ të disponueshëm që u jep përgjigje anëtarëve të familjes ose individit të radikalizuar edhe pasi janë arritur objektivat.

Profesionistët e mbështetjes së familjes kanë treguar se është sfiduese të vlerësohet se kur duhet të përfundojë një program mbështetjeje. Një arsye është se disa individë përdorin manipulimin për të mashtruar profesionistët e mbështetjes dhe familjen/rrethet shoqërore që të mendojnë se ata janë në një drejtim tjetër. Të rinjtë inteligjentë, që janë veçanërisht të aftë të kuptojnë se çfarë sjelljeje dhe fjalësh priten prej tyre, mund ta përdorin këtë për të mbuluar mendimet dhe planet e tyre reale. Për të parandaluar këtë nuk ka një shkop magjik. Profesionalizmi dhe përvoja e profesionistëve të mbështetjes së familjeve dhe psikologëve zakonisht do të luajnë një rol të rëndësishëm në këto raste.

Hapi 10: Ndërtimi dhe zhvillimi i kapacitetit të mbështetjes së familjeve

Për të kryer veprimet e kërkuara në hapat 1 deri 9, është e rëndësishme që të ketë një kapacitet mbështetjeje dhe të vazhdohet zhvillimi dhe forcimi i këtij kapaciteti. Sugjerimet e mëposhtme bazohen në përvojat e mbështetjes së familjeve në disa Shtete anëtare të BE-së, dhe mund të ndihmojnë në ndërtimin dhe zhvillimin e kapacitetit efikas për mbështetjen e familjeve. Politikëbërësit kombëtarë dhe lokalë dhe punonjësit e administratës kanë një rol të rëndësishëm në krijimin e kushteve që nevojiten për të zhvilluar kapacitetin në këtë fushë:

- të fillojnë punën në formën e një projekti pilot / eksperimenti në të cilin ka vend për procese prove dhe për të mësuar nga gabimet, si dhe për të mësuar se cili është më efikas në kontekstin kombëtar/lokal;
- të shqyrtohet se cila punë organizate do të funksiononte më mirë në kontekstin kombëtar/lokal; p.sh. brenda policisë ose shërbimeve sociale, si OJQ më vete, si pjesë e një organizate tjetër përkujdesjeje, që tashmë ka përvojë në mbështetjen e familjeve në zona të ndryshme;
- të sigurohet vazhdimësia përmes burimeve (financiare, njerëzore, politike);
- të mbështetet zhvillimi i një rrethi më të gjerë rreth organizatës së mbështetjes së familjeve me të cilin mund të bashkëpunojnë (p.sh. policia, shërbimet sociale, zyra e punësimit, shërbimet e sigurisë, psikologët);

- të garantohet siguria e profesionistëve të mbështetjes së familjes (p.sh. si të punojnë me emrat, adresat e emailit, mbrojtjen e policisë, numrat e telefonit etj.);
- të krijohet një grup me diversitet profesionistësh të mbështetjes së familjeve (meshkuj, femra, sfonde të ndryshme kulturore, aftësi të ndryshme gjuhësore, sfonde të ndryshme profesionale);
- të zhvillohet një strategji komunikimi për të informuar publikun rreth mënyrës se si disponohet mbështetja e familjes për parandalimin e radikalizimit;
- të garantohet angazhimi nga sektori i shëndetit mendor për të ndihmuar profesionistët e mbështetjes së familjeve dhe për të shmangur listat e gjata të pritjes;
- të përfshihen, kur është e mundur, prindërit që kanë pësuar përvoja të ngjashme dhe që duan të ndajnë reflektimet dhe mësimet e nxjerra me të tjerët;
- të shihet legjislacioni i privatësisë dhe të ofrohen mundësitë që të zhvillohen protokolle specifike për privatësinë dhe ndarjen e informacionit për të lejuar ndarje më të lehtë dhe më efektive rreth çështjeve;
- të lejohet trajnim shtesë dhe ndarje e praktikës më të mirë mes dhe brenda shteteve për të përmirësuar kapacitetin profesional si edhe aftësitë e profesionistëve të mbështetjes së familjeve;
- të sigurohet që profesionistët e mbështetjes së familjeve të ndihen të mbështetur nga organizatat e tyre dhe nga lidhshipi politik (si lokal ashtu edhe kombëtar) që të ndihen të fuqizuar dhe në gjendje të trajtojnë situata të vështira që kanë vëmendje të lartë nga media.
- të krijohet një strukturë mbështetëse për profesionistët e mbështetjes së familjeve duke qenë se puna me familjet vulnerabël është shumë kërkuese dhe ka një barrë emocionale/psikologjike; struktura mund të përfshijë grupe konfidenciale në të cilat profesionistët mund të ndajnë shqetësimet/frikën e tyre, mbështetje psikologjike, dhe kontakt të mjaftueshëm me menaxhimin e organizatës;
- të vlerësohet puna që bëhet me familjet për të krijuar praktikën më të mirë bazuar në prova dhe për të mësuar nga gabimet.

Praktika në veprim: Njësia e Mbështetjes së Familjeve – Holandë

Njësia e Mbështetjes së Familjeve është një organizatë, e pavarur nga qeveria, që ofron informacion të specializuar, këshilla dhe mbështetje për ata që janë të shqetësuar rreth një anëtar familjeje të radikalizuar. Ai funksionon bashkë me programin holandez Exit. Procesi nis me një diskutim me të gjithë anëtarët e familjes, dhe ndiqet nga hartimi i një plani masash bashkë me familjen, i cili përfshin aspekte të ndryshme të jetës (siç janë radikalizimi, shëndeti (psikologjik), puna/shkolla, financat). Pjesëmarrja është vullnetare; profesionistët punojnë në shtëpinë e familjes, kudo që mund të jetë ajo në Holandë. Komuna në të cilën jeton familja njoftohet gjithmonë rreth përfshirjes së Njesisë së Mbështetjes së Familjeve dhe duhet të jetë dakord me ofrimin e mbështetjes për familjen.

Njësia u ngrit si pjesë e programit gjithëpërfshirës holandez të masave për të luftuar xhihadizmin, që ka 38 masa. Masa 23b ishte ngritja e një strukture për mbështetjen e familjeve.

Metodologjitë e tyre përfshijnë elementet e mëposhtme:

- një protokoll të rreptë privatësie: informacioni ndahet me komunën ose policinë vetëm kur ka një rrezik sigurie ose pasi ka dhënë leje familja – besimi është thelbësor;
- transparencë në veprimet dhe marrëdhëniet me organizatat e tjera;
- të gjithë menaxherët e rasteve janë punonjës profesionistë të ndihmës/shëndetit, që lidhen me komunën dhe organizata të tjera për t'u kujdesur për nevojat e tjera si p.sh. strehimin ose punët;
- një përjasje multidisiplinore, me takime dy herë në javë duke përfshirë të gjithë menaxherët e çështjeve, infermier psikolog, psikiatër kur nevojitet, terapist sistemi, studiues, trajnues me përvojë të gjerë në rrjetin xhihadist në Holandë dhe një teolog/ekspert islam; menaxherët e çështjeve flasin gjuhët e grupit të synuar;
- çështjet zakonisht mbërrijnë përmes komunave, dhe Njësia e Familjes duhet të jetë sa më afër që të jetë e mundur me atë që organizohet tashmë lokalisht; sigurohet gjithashtu edhe mbulim në të gjithë vendin.

[Më shumë informacion rreth Njesisë së Mbështetjes së Familjeve të Holandës.](#)

Translated within: